

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ 96/19 и 110/19), како и врз основа на член 50 став 6 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/2019) министерот за образование и наука донесе скратена наставна програма по наставниот предмет *албански јазик* за I одделение на деветгодишното основно образование за учебната 2020/21 година.

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 50 alineja 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.161/2019) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin e shkurtuar mësimor nga lënda e gjuhës shqipe për klasën I (e parë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021

**PROGRAMI MËSIMOR I
SHKURTUAR**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

GJUHË SHQIPE

KLASA I - rë

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

GUSHT, 2020/21

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën *gjuhë shqipe* për klasën e I-rë, në arsimin fillor nëntëvjeçar bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura me programin mësimor për lëndën mësimore i cili në formë të rregullt realizohet në përputhshmëri me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar vërtetohen temat e caktuara dhe njësit mësimore që do të realizohen për 159 ditë pune mësimore, me kohëzgjatje nga 30 min., gjatë së cilës duhet ruajtur fondi i paraparë javor të vërtetuara në programin e rregullt, konkretisht për lëndën mësimore me 6 orë mësimore në javë janë paraparë 192 orë në program të shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar bazohet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktiviteteteve të parapara në programin e rregullt mësimor.

Numri rendor	FUSHAT PROGRAMORE	NUMRI I ORËVE
1	TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT	75
2	LETËRSI	52
3	TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA	20
4	KULTURA E MEDIËS	15
5	BAZAT E LEXIMIT DHE SHKRIMIT	30
		192

2. PASQYRA E FUSHAVE PROGRAMORE DHE NJËSIVE MËSIMORE

Fusha programore – Të dëgjuarit dhe të folurit (75 orë)

Përzgjidhni sipas librit që punoni

Njësitë mësimore

1. Ushtrime në të folurit „Të prezantohemi”
2. Bisedë rreth temës „Unë në shkollë”
3. Bisedë Rruga për në shkollë...
4. Bisedë: Çka më bën të lumtur, çka më hidhëron, çka më ...
5. Shprehje kulturore: zonjë, zotëri, ju lutem, më falni, urdhëroni, faleminderit, tungjatjeta...
6. Si komunikojmë me të tjerët (dialog, bashkëbisedë,)
7. Të folurit me zë të ulët dhe me zë të lartë
8. Bisedë: filmat vizatimor
9. „Albumi Anës” dallimi i tingullit dhe shkronjës „A”,
10. „Babai i Anës” dallimi i shkronjës dhe tingullit „B”
11. „Cirku” dallimi i shkronjës dhe tingullit „C”,
12. „Çadra ime” dallimi i shkronjës dhe tingullit „Ç”,
13. „Ditëlindja e Dianës” dallimi i tingullit dhe shkronjës „D”
14. „Dhëmbi i sëmurë” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Dh”
15. Lojë: Në bibliotekë
16. „ERA” dallimi i tingullit dhe shkronjës „E”,
17. „Ëndërra e Besimit” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Ë”,
18. „Flutura dhe gishtoja” dallimi i tingullit dhe shkronjës „F”,
19. „Gara” dallimi i tingullit dhe shkronjës „G”,
20. „Gjinkalla dhe milingona” dallimi i ting. dhe shkronjës. „Gj”,
21. „Hëna” dallimi i tingullit dhe shkronjës „H”,
22. Bashkëbisedë „Punën e sotme mos e le për nesër”
23. „Iriqi dhe mullet” dallimi i tingullit dhe shkronjës „I “,

24. „Java e zogut” dallimi i shkronjës dhe tingullit „J”,
25. „Klasa e Kaltrinës” dallimi i tingullit dhe shkronjës „K”,
26. „Lodra ime e dashur” dallimi i tingullit dhe shkronjës „L”,
27. „Llastiku” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Ll”,
28. Bisedë: Çfarë bëj unë gjatë javës
29. Lojë gojore: Me shkronjën...me shkronjën...
30. Komunikim: lodra ime e dashur
31. Bashkëbisedë: sillemi hijshëm
32. „Motra mjekë” dallimi i tingullit dhe shkronjës „M”,
33. „Nina - nana” dallimi i tingullit dhe shkronjës „N”,
34. „Një ditë në fshat” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Nj”,
35. „Ora vrapon” dallimi i tingullit dhe shkronjës „O”,
36. „Pikniku në pranverë” dallimi i tingullit dhe shkronjës „P”,
37. Bisedë rreth ninullave (këndimi i tyre)
38. Pyetje – përgjigje: në fshat...
39. Profesionet e prindërve të mi (mjeku)
40. Stimulimi i nxënësve për të komunikuar mes veti
41. „Qyteti i madh” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Q”,
42. „Roboti i Ronit” dallimi i tingullit dhe shkronjës „R”,
43. „Rruga ime” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Rr”,
44. „Semafori magjik” dallimi i tingullit dhe shkronjës „S”,
45. Pyetje – përgjigje: Në qytet... sjellja në rrugë
46. Bisedë rreth mjeteve kompjuterike
47. Biseda telefonike
48. Pantomimë: polici i komunikacionit
49. Mësuesja ime e parë –komunikim mes veti
50. Bisedë: Erdh pranvera

51. Dallimi i tingullit dhe shkronjës „Sh”,
52. „Televizori dhe libri” dallimi i tingullit dhe shkronjës „T”,
53. „Thuprat e bashkuara” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Th”,
54. „Udhëtimi” dallimi i tingullit dhe shkronjës „U”,
55. „Vetëtima” dallimi i tingullit dhe shkronjës „V”,
56. Pyetje – përgjigje: Në shkollë....
57. Çka të pëlqen TV-ja ose libri?
58. Bashkëbisedë: Bashkimi bën fuqi
59. Më pëlqen të udhëtoj
60. Flasim për pranverën
61. A duhet të frikësohemi nga vetëtima
62. Bisedë: 1 Prilli
63. „Xixëllon në qiell” dallimi i tingullit dhe shkronjës „X”,
64. „Xhuxhat dhe Borëbardha” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Xh”,
65. „Ylberi” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Y”,
66. „Zogu dhe djali” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Z”,
67. „Zhurmat dhe tingujt” dallimi i tingullit dhe shkronjës „Zh”,
68. Bisedë: qielli plot me ...
69. Flasim për ylberin
70. Bashkëbisedë: bimët që i njoh...
71. Tregim sipas fotografive „Dhelpra dhe iriqi”
72. Tregim sipas fotografive „Beni dhe kumbullat”
73. Imitojmë zhurmat dhe tingujt
74. Flasim për pushimet verore
75. Bashkëbisedë: unë në klasën e dytë

Fusha programore – Letërsi (52 orë)

Njësitë mësimore

1. Pyetje-përgjigje: Shokët dhe shoqet në shkollë
2. Vjershë „Unë tani u rrita” (ose zgjedhje sipas librit që punoni)
3. Pasurim i fjalorit me temë: Në klasën time ka
4. Pasurimi i fjalorit (libri, fletorja, fleta e punës, letrat me ngjyrë, mjetet për vizatim, ngjitësi...)
5. Pasurimi i fjalorit (mjetet në klasë: shkumësi, shpuza, dërrasa e zezë...)
6. Përpunimi i përrallës: „Nëna, dhia dhe kecat“
7. Vjershë për vjeshtën
8. Pasurimi i fjalorit
9. Lexim artistik i përvjeshtëm
10. Shfletimi i ilustrimit „Në kopshtin tim” (ose zgjedhje sipas librit që punoni)
11. Pasurim fjalori
12. Lexim me interpretim „Kolltuku magjik” (ose zgjedhje sipas librit që punoni)
13. Flasim për personazhet
14. Lexim artistik me temë „Dita e Alfabetit”
15. Vjershë për Flamurin
16. Flasim për festën 28 Nëntori
17. Lexim i një përralle
18. Krahaso e përshkruaj
19. Shfletimi i librave me ilustrime
20. Vjershë për dimrin
21. Pasurimi i fjalorit
22. Përpunimi i vjershës për Vitin e Ri
23. Lexim artistik: Viti i Ri
24. Lexim i tekstit „I sëmuri dhe mjeku” (ose zgjedhje sipas librit që punoni)

25. Personazhet negativ dhe pozitiv në krijimtarinë letrare
26. Përpunimi i një përralle popullore shqipe
27. Përpunimi i një përralle popullore nga kulturat tjera
28. Njohja me fabulat
29. Vjershë për luleborën
30. Përpunim i tregimit „Plaku dhe bijtë e tij”
31. Njohja me fjalët e urta
32. Gjëgjëza për orën
33. Lexim i tekstit „7 Marsi – Dita e mësuesit”
34. Lexim artistik për 8 Marsin
35. Vjershë për Nënë
36. Njohja me fjalët e urta
37. Tregim i pavarur nga vëzhgimi i natyrës
38. Lexim: rrugëve të qytetit tim
39. Vjershë: semafori
40. Lexim artistik për pranverën
41. Lexim i një përralle
42. Personazhet pozitiv dhe negativ nga përralla
43. Gjëgjëza
44. Vjershë për dallëndyshen
45. Lexim: në pemishten time
46. Mesazhet nga tregimi „Thuprat e bashkuara”
47. Lexim artistik: Borëbardha dhe xhuxhet
48. Personazhet pozitiv dhe negativ nga përralla
49. Vjershë „Yll i vogël”
50. Leximi i një fabule
51. Vjershë „Zana dhe zogu”

Fusha programore – Të shprehurit dhe krijimtaria (20 orë)

Njësitë mësimore

1. Vëzhgimi dhe përshkrimi i rrugës
2. Të treguarit e përshtypjeve nga dita e parë në shkollë.
3. Përshkrimi i mësueses, shokut, shoqes...
4. Flasin për familjen dhe për anëtarët e familjes
5. Bisedë: drunjtë në vjeshtë
6. Bisedë: Si e festova ditëlindjen
7. Bisedë: kujdesi për dhëmbët
8. Do të krijojmë përrallë dhe dramatizimi i përrallës
9. Përgatitje e letrës për Gjyshin dimër
10. Përshkrim: dëshirat e mia për Vitin e Ri
11. Tregim sipas seri fotografish
12. Dramatizim: mjeku dhe i sëmurit
13. Shprehje artistike për pranverën
14. Ndaji rolet dhe luaje lojën
15. Tregim sipas kujtesës
16. Bërja e albumit për pemët dhe perimet e hershme
17. Përshkrim i lojërave pranverore
18. Përshkrim dhe prezantim i një ngjarjes
19. Krijimtari gojore: ngjyrat e ylberit
20. Lamtumirë shkollë

Fusha programore – Kultura e medies (15 orë)

Përzgjidhni sipas librit që punoni

Njësitë mësimore

1. Emisionet në TV për fëmijë
2. Filmi vizatimor
3. Filmat e animuar
4. Reklama
5. Shohim filma për fëmijë
6. Ndjekim emisione për fëmijë
7. Bisedojmë për emisionet e fëmijëve
8. Vizita në bibliotekën e shkollës
9. Njihemi me revista për fëmijë
10. Çfarë janë radio emisionet për fëmijë
11. Shfaqje me kukulla
12. Krijojmë shfaqje me kukulla
13. Shfletimi i lustrimeve dhe përpilimi i një reviste
14. Shohim shfaqje teatrale për fëmijë
15. Vizitë një qendre informative

Fusha programore - Bazat e leximit dhe shkrimit (30 orë)

Njësitë mësimore

1. Shfletojnë dhe lexojnë libra me ilustrime
2. Dallojnë ilustrimet nga teksti në librin me ilustrime
3. Bisedojmë rreth asaj që kanë kuptuar nga libri me ilustrime
4. Vëzhgojnë dhe „lexojnë” simbole, semafori, H, shenja komunikacioni ...

5. Loja „Letra”
6. Dallojnë fjalë të shkurtra dhe të gjata
7. Dallojnë tingullin në fillim të fjalës
8. Vizaton një send që nis me një tingull të caktuar
9. Formon fjalë sipas tingullit të dhënë
10. Plotëson fjalinë me fjalë
11. Plotëson fjalinë me tingullin e pa shqiptuar
12. Vizatimi i elementeve të sendeve të ndryshme
13. Vizatimi i vijave të drejta, të ndërprera, si pjesë të rrugës, shtëpive, diellit etj.
14. Shkrimi (vizatimi) i elementeve të shkronjave në hapësirë të kufizuar dhe në drejtime të duhura
15. E njeh emrin e shkruar në çantën e vetë dhe të shokëve të vetë
16. „Leximi” i mbishkrimeve dhe reklamave, i emrit të vet dhe fjalëve që i has më shpesh në jetën e përditshme.
17. Lojëra me katror ku janë shënuar shkronja të ndryshme
18. Presin shkronja nga revistat dhe sipas ilustrimeve të dhëna i njohin shkronjat e para dhe të fundit
19. Njohja dhe modelimi i shkronjave „A”, „B”, „C”, „Ç”,
20. Njohja dhe modelimi i shkronjave „D”, „Dh”, „DH”, „E”,
21. Njohja dhe modelimi i shkronjave „Ë”, „F”, „G”, „Gj”
22. Njohja dhe modelimi i shkronjave „H”, „I”, „J”, „K”,
23. Njohja dhe modelimi i shkronjave „L”, „LL”, „M”, „N”
24. Njohja dhe modelimi i shkronjave „NJ”, „O”, „P”, „Q”
25. Fjalë, zë, fjali
26. Vizatojmë elementet e shkronjave
27. Hulumtojmë materiale të ndryshme dhe mjete të shkruara
28. Njohja dhe modelimi i shkronjave „R”, „Rr”, „S”, „Sh”
29. Njohja dhe modelimi i shkronjave „T”, „Th”, „U”, „V”
30. Njohja dhe modelimi i shkronjave „X”, „Xh”, „Y”, „Z”, „Zh”

3. Rekomandime didaktike

Si bazë për realizimin e programit mësimor të shkurtuar për lëndën e *gjuhës shqipe* është programi i rregullt (fushat programore, qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet e propozuara, metodat).

Fëmija që nga mosha e hershme paraqet kureshtje dhe interes për botën që e rrethon, ashtu që njohuritë e tyre mësimdhënësi do ti shfrytëzojë për të sendërtuar orët mësimore për këtë lëndë mësimore. Duke marrë pjesë në lojërat didaktike, gjatë shumë bashkëbisedimeve, ushtrimeve dhe duke shfrytëzuar mjete të llojllojshme, nxënësit pasurohen me fjalorin e tyre, i njohin dhe në formë të drejtë i shqiptojnë fjalët, që formon një bazë të fortë mbi atë që do të mësojnë në klasën e parë.

Aktivitetet më shpesh do të realizohen në klasë, në vazhdimësi me komunikim verbal me mësimdhënësit e tyre, por gjithashtu, me përdorimin e mjeteve të llojllojshme vizuale (fotografi, aplikacione, maketa, revista me fotografi, gazeta, radio dhe emisione televizive, me përmbajtje të ndryshme dixhitale etj.)

Ora mësimore është me kohëzgjatje prej 30 minuta. Gjatë planifikimit të orës mësimore mësimdhënësi është i nevojshëm ta shkurtojë pjesën hyrëse më së shumti 5 minuta dhe duke përdor teknika të përshtatshme t'i përfshijë dhe motivojë nxënësit për realizimin e qëllimeve të aktiviteteve për mësimnxënie. Metodrat dhe aktivitetet për mësimnxënien e nxënësve duhet të përshtatet me kohëzgjatjen e orës mësimore, por gjatë së cilës duhet ti përmbahet cilësisë së mësimin dhe mësimnxënies. Aktiviteti i mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të zgjas deri më 20 minuta. Metodrat më efikase e të mësuarit në mësimin e gjuhës shqipe janë metodrat të cilat nxënësit i vendosin në pozicionin aktiv në procesin e të arriturave të njohurive dhe shkathtësive.

Në klasën e parë gjuha shqipe është lëndë e vetme në të cilën gërshetohen (integrohen) kërkesat për shkrim - leximin, përfitimin e njohurive gramatikore, për pasurimin e fjalorit etj.

Temat nga këto lëndë do të ndihmojnë zhvillimin e shkathtësive të dëgjimit dhe të folurit, formimin kulturor të fëmijës dhe pavarësimin individual të tyre.

Metodrat, format dhe mjetet e punës për të gjitha fushat programore që parashikohen për lëndën e Gjuhës shqipe këshillohet shfrytëzimi dhe kombinimi i të gjitha metodave, formave dhe mjeteve të mësimdhënies **ndërvepruese (interaktive), aktuale dhe bashkëkohore**, sidomos të: **metodës së lojës, metodës për zgjidhjen e problemeve dhe metodës kërkimore** që janë më adekuate për specifikat e të nxënësve të fëmijët e kësaj moshe.

Qasja individuale ndaj punës edukative-arsimore:

Në bazë të njohurive shkencore për dallimet në zhvillimin e fëmijëve, është e nevojshme të bëhet përshtatja e mësimdhënies me zhvillimin, nevojat dhe arritjet individuale të nxënësve. Me fjalë të tjera, nevojitet zbatimi i teknikave dhe strategjive që i kërkon **qasja individuale** gjatë realizimit të punës edukative - arsimore me nxënësit.

Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e mësimdhënies:

Familja është shkolla e parë për fëmijët dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës. Gjithashtu, nevojiten **mjete audio-vizuale, auditive, vizuale dhe mjete të tjera me veti kinetike** – programe televizive, emisione për fëmijë, filma të animuar dhe artistik për fëmijë; video incizime, disketë DVD e CD-së me filma të animuar e me filma artistikë dhe me tekste të letërsisë popullore dhe artistike, me ngjarje të regjistruara, ditëlindje, me shfaqje teatrore e me shfaqje kukullash etj.; audio incizime me zëra të incizuar, emisione lajmesh të incizuara, tekste të lexuara në mënyrë artistike; aplikacione, ilustrime, makete; skena kukullash dhe të teatrit; sende të lëvizshme me efekte akustike dhe sende të tjera sipas nevojave që kërkon mësimdhënia e kësaj lënde.

1. Normative për stafin mësimdhënës

Programi i shkurtuar realizohet nga mësuesi në përputhje me normativin për kuadrin arsimor të dhënë në programin e rregullt mësimor

Programi i shkurtuar nga lënda e gjuhës shqipe për klasën e I të arsimit fillor nëntëvjeçar

4. Норматив за наставен кадар

Скратената наставна програма по албански јазик за прво одделение ја реализира наставик согласно нормативот за наставен кадар даден во редовната наставна програма.

Скратената наставна програма по наставниот предмет албански јазик за прво одделение на деветгодишното основно образование ја утврди

Арх. Бр. 12-8424/229

16.09.2020

Министер за образование и наука

Мила Царовска